

Cilësi më të mirë e tokës
Cilësi më të mirë e ujit

Mbrojta e biodiversitetit
Diversiteti më i madh gjenetik

Treva tradicionale
Vendbanime të mbrojtura

MASAT AGRO- EKOLOGJIKE

SFIDË PËR BUJQIT

ruaje TRADITËN , investo në ARDHMËRINË



Projekti finansohet nga
Bashkimi Evropian



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë
dhe Administrimit të Ujrave

Masa agro-ekologjike, cfarë është kjo?

Masat Agro ekologjike është politikë për nxitje të veprimtarisë bujqësore e dobishme për mjedisin dhe trevat rurale. Ajo është e orientuar drejt promovimit të praktikave prodhuese bujqësore për shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës bujqësore, mbrojtje dhe përmirësim të ambientit jetësor dhe të trevave rurale, me qëllim të ruajtjes së diversitetit bimor dhe shtazor dhe avancimit të tokës, ujit dhe ajrit.

Masat Agroekologjike sigurojnë mbështetje financiare për bujqit si plotësim të të ardhurave për zbatimin e obligimeve agroekologjike, përkatësisht mënyrë ekologjike e përpunimit, ujitjes, plehërimit, mbrojtjes së bimëve dhe biodiversitetit, kthimi i bujqësisë tradicionale e kështu me radhë.

Masat Agroekologjike zbatohen në nivel kombëtar, regjional ose në nivel lokal. Mund të jenë të ndryshme, varësisht nga karakteristikat natyrore të regjionit dhe specifikat e kushteve tokësore-klimatike. Ato janë mjet për arritje të qëllimeve për mbrojtje të ambientit jetësor. Pa marrë parasysh se masat agroekologjike janë të ndryshme, çdo mase i përmban objektivat e përgjithshme për ruajtjen e ambientit jetësor dhe të karakteristikave natyrore.

Parimet themelore të masave agroekologjike

Masat agroekologjike bazohen në disa parime themelore për mbrojtje dhe avancim të ambientit jetësor gjatë përpunimit të tokës dhe kultivimit të bagëtisë:

- Agroekologjia është strategji për zbatim të politikës për mbrojtje dhe avancim të ambientit jetësor të ekonomisë bujqësore. Në këtë drejtim, politika në nivel shtetëror përcakton ku dhe si ajo zbatohet, për të kënaqur nevojat e ndryshme për mbrojtje të ambientit jetësor;
- Pagesat agroekologjike iu ndahen ekonomive bujqësore bartës të të cilave në baza vullnetare, kanë nënshkruar marrëveshje për zbatim të standardeve më të larta ekologjike të ekonomisë bujqësore për periudhë prej pesë vitesh;
- Pagesat agroekologjike paraqesin mënyrë e barazimit të profitabilitetit të prodhimit agroekologjike bujqësore në krahasim me atë konvencionale. Gjatë përllogaritjes së lartësisë të pagesave agroekologjike merret parasysh lartësia e të ardhurave të humbura dhe motivimi financiar të bujkut për zbatimin e masave agroekologjike;
- Pagesat agroekologjike iu ndahen ekonomive bujqësore bartësit e të cilave i tejkalojnë standardet themelore (minimale), (parimet e praktikës së mirë bujqësore dhe higjienike) të tërë ekonomisë bujqësore për periudhë prej pesë vitesh.

4

Detyrimet për fermeret

Bujqit që të mund ti përdorin mjetet financiare, duhet të:

- Ti respektojnë standardet e detyrueshme minimale (themelore) të cilat i përfaqësojnë standardet kombëtare dhe kanë të bëjnë me mbrojtjen e tokës nga erozioni, të materies organike të tokës, strukturën e tokës, nivelin minimal të kultivimit, mbrojtjen e biodiversitetit biologjik, ruajtjen e karakteristikave të trevave në regjionet rurale si dhe mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave;
- Pajtohen se do ta zbatojnë masën në periudhë prej 5 vitesh, duke filluar që nga viti kur janë paraqitur;
- Do të paraqesin kërkesë për pagesë financiare çdo vit, për tërë kohëzgjatjen e kontratës;
- Në mënyrë të detyrueshme do të marrin pjesë në trajnime (së paku 4 orë në vit) gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës.

Aktivitetet të cilat bujqit duhet t'i zbatojnë dallojnë për çdo masë, varësisht nga lloji i tokës bujqësore dhe kulturave bujqësore, praktikave tradicionale bujqësore, mbrojtja e diversitetit të trevave, biodiversitetit dhe prioritetet ekologjike.

5

Që bujku të mund të parashtrijë kërkesë për cilën do qoftë nga masat, patjetër duhet ti plotësojë kushtet e obligueshme vijuese:

- Të jetë i regjistruar në Regjistrin Unik të ekonomive bujqësore me të gjitha kapacitetet prodhuese;
- Sipërfaqja minimale e tërësishme që lejohet është 0,3 ha, (me parcela të cilat nuk janë më të vogla se 0,1 ha);
- Të gjitha bagëtitë shtëpiake duhet të jenë të shënuara dhe të evidentuara në Regjistrin për identifikim dhe regjistrim të bagëtitë shtëpiake;
- Të përgatitet plan agroekologjik për aktivitetet bujqësore të ekonomive bujqësore, në përputhje me detyrimet e defnuara në kontratën për mbështetje financiare;
- Të mbajë evidencë të detyrueshme (punuese) për të gjitha aktivitetet bujqësore të kryera në ekonominë bujqësore për tërë kohëzgjatjen e kontratës;
- Mund të parashtrijë kërkesë për një ose për më shumë masa agroekologjike, por nuk guxon ti kombinojë në parcelë të njëjtë.

Kush mund të shfrytëzojë mbështetje financiare agroekologjike

Shfrytëzues të mbështetjes financiare agroekologjike mund të jenë të gjitha ekonomitë bujqësore (**persona fizik dhe juridik**), të regjistruar në Regjistrin Unik për ekonomi bujqësore, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural.

Persona fizik

Ekonomi familjare bujqësore, të regjistruara në Regjistrin Unik për ekonomi bujqësore.

Persona juridik

Shoqata tregtare në pronësi private, që merren me bujqësi si aktivitet parësor ekonomik.

Kooperativa aktivitet parësor ekonomik i të cilave është bujqësia.

Planifikimi dhe evidentim i obligimeve agroekologjike

Plani agroekologjik

Çdo kërkues i masave agroekologjike në vitin e parë ka detyrim, bashkë me kërkesën unike, të bashkëngjijt edhe plan agroekologjik. Plani duhet të ofrojë zgjidhje për të gjitha masat të cilat do të zbatohen në ekonomitë bujqësore. Në përgatitjen e të njëjtit, bujku mund të kërkojë ndihmë nga ana e shërbimeve këshillëdhënëse.

Evidencë punuese e ekonomive bujqësore

Mbajtja e evidencës punuese e ekonomisë bujqësore është e detyrueshme për të gjithë shfrytëzuesit të cilët janë të kyçur në zbatimin e masave agroekologjike.

Bujku është i obliguar ta ruajë evidencën punuese si provë për zbatimin e obligimeve të ndërmarra, së paku 5 vjet pas skadimit të kontratës.

Evidenca e ekonomisë bujqësore duhet ti përmbajë të gjitha informacionet mbi aktivitetet bujqësore, si për shembull: kositje, lëvrim, mbrojtje e bimëve, plehërim e kështu me radhë.

Zbatimi I masave agroekologjike

Agjencioni për mbështetje financiare në bujqësinë dhe zhvillimin rural është përgjegjës për zbatimin e masave në pajtim me programet kombëtare dhe programin IPARD për periudhën 2007-2013. Agjencioni kryen: pranim të kërkesave, evidentim, kontroll administrativ, kontroll në vetë vendin dhe aprovim të pagesave për masat agroekologjike.

Kërkuesit për masat agroekologjike vullnetarisht nënshkruajnë kontratë 5-vjeçare dhe çdo vit i dorëzojnë kërkesë Agjencionit. Mënyra e parashtrimit të aplikacioneve për pjesëmarrje në masat agroekologjike, si dhe kriteret për çdo masë, do të përshkruhen në aktin nënligjor me të cilin do të rregullohen pagesat agroekologjike në baze vjetore.

Mospërmbushja e detyrimeve agroekologjike sjell sanksione përkatëse, dhe madje edhe përjashtim nga programi agroekologjik.

Shfrytëzimi i masave agroekologjike është mbi baza vullnetare.

Shembuj të masave agroekologjike të zbatuara në Bashkimin Evropian

- Bujqësia organike;
- Ruajtje e racave dhe llojeve të rrezikuara lokale;
- Metoda të qëndrueshme të ekonomizimit bujqësor, për shembull:
 - Ulje e shfrytëzimit dhe e planifikimit të shfrytëzimit të plehrave;
 - Ulje e shfrytëzimit dhe e menaxhimit më të mirë me prodhimet për mbrojtje të bimëve;
 - Aplikim i ndërrimit të kulturave bujqësore (rotacion i kulturave).
- Krijim, ruajtje e karakteristikave të trevave/ekologjike (për shembull: kufij-meja natyrore, zona mbrojtëse, breza të mbrojtura nga era);
- Menaxhim i qëndrueshëm i zonave të ujitura dhe/ ose normat e ujitjes;
- Aktivitete për ruajtje të truallit (për shembull: teknika të përpunimit për tu penguar erozioni i tokës, mbulesë e gjelbër, mbulesë nga kashta dhe plehra të stallës);
- Aktivitet për ruajtje të vendbanimeve natyrore të bagëtive të rëndësishme për biodiversitetin (për shembull: lënie e stërnishtave dimërore, përshtatje e periudhave për kositje);
- Mirëmbajtja e karakteristikave të peisazhet (p.sh.:mure guri, teraca, kufijë mes shtëpive);
- Ruajtje e kullotave (për shembull: kufizim i shkallës së dendësisë së bagëtisë sipas kapaciteteve)dhe krijim i kullotave (përfshire edhe konversionin e tokës së punueshme në kullotë);
- Mbrojtje e biodiversitetit (për shembull: vendbanime me vlerë më të lartë, mbrojtje e shpendëve).

Masa agroekologjike në Bashkimi Evropian - rrëfim i suksesshëm

Bashkimi Evropian e mbështet mbrojtjen e ambientit jetësor dhe zbaton masa agroekologjike që nga viti 1992. Ato janë të zbatueshme lehtë në ekonomizimin bujqësor dhe mundësojnë mbrojtje të ambientit jetësor në nivel kombëtar, regjional apo lokal. Duke pasur parasysh se këto masa janë instrument i fuqishëm për arritje të qëllimeve ekologjike Bashkimi Evropian në periudhën financiare 2007-2013 i obligon shtetet-anëtare të ndajnë te paktën 25% nga buxheti për zhvillimin rural dhe për masat agroekologjike. Korniza e njëjtë financiare është e planifikuar edhe për periudhën e ardhshme për vitet 2014-2020.

Ku mund te merni më shumë informata?

Në zyrat lokale të

Agjencionit për mbështetje të zhvillimit të bujqësisë (APZHB)

Në ueb faqet:

www.mzsv.gov.mk

www.ipardpa.gov.mk

www.agencija.gov.mk



PROJEKT

Projektin e
zbaton ADT

Zhvillim dhe zbatim
i masave agroekologjike

Ky publikim është i botuar me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e ADT project GmbH bashkë me LWK, GZC dhe GISS dhe nuk mund të konsiderohet se i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.